


Flash Zjarri në Krujë, Ministri Lamallari: Policia ka arrestuar autorin e zjarrvënies së qëllimshme

POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit


- 1




FIFA-ni Mocion mosbesimi dhe turne paralele
- 2




Infantino kërkon ndihmën e Trump, formohet aleanca që do të paralizonte
- 3




'Marrëveshje ose dorëzim të plotë' Donald Trump paralajmëron se
- 4



blokada detare ndaj Iranit do të vazhdojë
- 5




pranë marrëveshjes për Hormuzin? Trump: Teherani po negocion, ky është shansi i fundit!
- 6



Rebelët Houthi godasin sërish Arabinë Saudite, NYT: Irani dhe Omanit
- 7



hatërmbetjetë, eja! 'Besën' e Ramës
- 8



70 ditë protestë/ Thirrje nga sheshi pas tërheqjes së Kullurit: Ata që kanë
- 9



Arbenita Ismajli ndan fotot me veshje arabe, shikoni si duket

Dogji 3 makina, arrestohet 43-vjeçari në Elbasan! Në pranga edhe një tjetër, u kap me pistoletë, fishekë e kokainë

Një 43-vjeçar është arrestuar në Elbasan, i dyshuar për djegien e 3 automjeteve në dy raste të ndryshme. Në një tjetër operacion, policia arrestoi një 32-vjeçar që u kap me pistoletë, 35 fishekë dhe kokainë.



Redaksia 8 Gusht, 11:15 | Përditësimi: 8 Gusht, 11:16

Share Post WhatsApp

A A

ELBASAN- Një 43-vjeçar është arrestuar në Elbasan, pasi dyshohet se u ka vënë flakën tre automjeteve në dy raste të ndryshme. **Ervis Kuka** dyshohet se më 7 gusht dogji me benzinë makinën që përdorej nga një 26-vjeçar, ndërsa nga hetimet rezultoi se ishte autor i dyshuar edhe i djegies së dy automjeteve të tjera më 28 qershor.

Në një tjetër operacion, policia arrestoi Dervish Rustën, 32 vjeç, i cili u kap në lagjen “Brigada 17 Sulmuese” me një pistoletë, 35 fishekë dhe një sasi të dyshuar kokaine.

Arma, municioni dhe lënda narkotike u sekuestruan nga policia.



LEXO EDHE:
Banorët kërkojnë hyrje-dalje në autostradën e re ‘Elbasan-Qafë Thanë’ pjesë e Korridorit VIII, ARRSH: Do ta shqyrtojmë

Njoftimi i policisë

Zbardhen dy raste të djegies së qëllimshme të automjeteve, identifikohet dhe vihet në pranga 43-vjeçari.

Qarkullonte me armë zjarri pistoletë me vete, me municion luftarak dhe lëndë narkotike kokainë, arrestohet në flagrancë 32-vjeçari.

Sekuestrohen armë zjarri, municion luftarak dhe lëndë narkotike.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Elbasan, në bashkëpunim me Forcën e Posaçme Operacionale të DVP Elbasan, bazuar në informacionet e siguruar në rrugë operative, në kuadër të planit të masave për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale, si dhe në vijim të veprimeve të thelluara hetimore, organizuan dhe finalizuan me sukses dy operacionet policore të koduara “Last Fire” dhe “Mbikëqyrja”.

* Në kuadër të operacionit policor të koduar “Last Fire”, si rezultat i veprimeve të kryera dhe i hetimeve të thelluara, u bë ndalimi me iniciativë i shtetasit: E. K., 43 vjeç, banues në Elbasan.

Ky shtetas dyshohet se më datë 07.08.2026, rreth orës 01:00, ka djegur me lëndë djegëse (benzinë), automjetin në përdorim nga shtetasi L. D., 26 vjeç, banues në Elbasan.

Gjithashtu, nga veprimet e thelluara hetimore, shtetasi E. K. dyshohet se është autor edhe i djegies së dy automjeteve, në pronësi të shtetasit E. H., më datë 28.06.2026.

* Në kuadër të operacionit policor të koduar “Mbikëqyrja”, u kap në flagrancë dhe u arrestua shtetasi: D. R., 32 vjeç, banues në Elbasan.

Ky shtetas u kap në flagrancë në lagjen “Brigada 17 Sulmuese”, ku, gjatë kontrollit fizik, iu gjet një armë zjarri pistoletë, 35 fishekë, si dhe një sasi lëndë narkotike të dyshuar kokainë.

Në vijim të veprimeve procedurale, shtetasi D. R. u arrestua në flagrancë për veprat penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” dhe “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”.

Arma e zjarrit, municioni luftarak dhe lënda narkotike u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

SI.E./Shqiptarja.com

TAG: Elbasan Ervis Kuka Dervish Rusta

Komente

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: GJKKO kërkon të kufizojë aksesin e mediave dhe të drejtave të gazetarëve gjatë seancave, a jeni dakord?

5 Gusht, 13:27

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera



PD: Ujësjellësi i Elbasanit gjobiti me 10 mijë lekë familjen e varfër që jeton me asistencë

7 Gusht, 15:02



Hapet një tjetër segment i Korridorit VIII, Rama publikon pamje: Nga dalja e fshatit Labinot-Fushë deri pas fshatit Mirakë, tashmë i aksesueshëm me 2 korsi vajtje-ardhje (VIDEO)

7 Gusht, 09:10



Rama publikon pamje nga punimet në pason Elbasan-Qafë Thanë: Investimi do e bëjë lidhjen e Jug-Lindjes me pjesën tjetër të vendit më të shpejtë

7 Gusht, 08:08




Zjarr tek tregu ushqimor në Elbasan, tymi i zi mbulon zonën, 3 zjarrfikëse shuajnë flakët (video)

6 Gusht, 14:36



Humbi betejën me sëmundjen e rëndë, ndahet nga jeta ish-trajneri i Sopotit, Besnik Çota

6 Gusht, 10:09



Zjarr pranë nënstationit elektrik në Elbasan, digjen vetëm shkurre e ullishte (VIDEO)

5 Gusht, 17:43



Dy fronte zjarri në qarkun e Elbasanit, era dhe temperaturat e larta favorizojnë përhapjen e flakëve (VIDEO)

5 Gusht, 14:24



Transportonin 24 emigrantë të paligjshëm drejt vendeve të BE-së, në pranga 3 të rinjtë në Elbasan (EMRAT+VIDEO)

5 Gusht, 10:56



Fier/ Flakët në Mallakastër jashtë kontrollit, situatë kritike në Riban e Ngraçan! Digjen masive me pisha, nesër rinis ndërhyrja nga ajri (VIDEO)

5 Gusht, 09:00



Nesër temperaturat deri në 37°C, IGJEO: Pjesa më e madhe e vendit e rrezikuar nga zjarret

4 Gusht, 18:44



Zjarrfikësit në terren, dy vatra zjarri mbeten aktive në qarkun e Elbasanit

4 Gusht, 17:21



Kompania ‘Vëllezërit Hysa’ gërryen pa kriter shtratin e Devollit, në pranga dy punonjësit! Në kërkim administratori 22-vjeçar

4 Gusht, 12:36

Lajmi i fundit



Zjarri në Krujë, arrestohet autori! Lamallari: Do të përballlet me pasojat ligjore! Janë evakuuar banorët në afërsi të vatrës

8 Gusht, 21:31

